

20202573302

L I G J I

I N D R Y S H I M I T T Ë L I G J I T T Ë M B R O J T J E S S Ë D E N O N C U E S V E

Neni 1

Në Ligjin e Mbrojtjes së Denoncuesve („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 196/15 dhe 35/18), në nenin 16 fjalët: „prej 3.000 deri 6.000 euro" zëvendësohen me fjalët: „prej 100 deri 500 euro", ndërkaq shlyhet nyja „i".

Neni 2

Në nenin 17 ndryshohet paragrafi (1) siç vijon:

„(1) Mikrotregtarit me 10 persona të punësuar do t'i shqiptohet gjobë në shumë prej 250 deri 500 euro, në kundërvlerë denari; përkatësisht tregtarit të vogël ose institucionit me 10 persona të punësuar do t'i shqiptohet gjobë prej 500 deri 1.000 euro, në kundërvlerë denari; përkatësisht tregtarit të mesëm ose institucionit me 10 deri 50 persona të punësuar do t'i shqiptohet gjobë prej 750 deri 1.500 euro, në kundërvlerë denari, përkatësisht tregtarit të madh ose institucionit me më shumë se 50 persona të punësuar do t'i shqiptohet gjobë në shumë prej 1.000 deri 2.000 euro në kundërvlerë denari, nëse vepron në kundërshtim me nenin 4 paragrafi (7) të këtij ligji.“.

Në paragrafin (2) fjalët: „30% nga gjoba e përcaktuar për institucionin, përkatësisht personin juridik" zëvendësohen me fjalët: „250 deri 500 euro në kundërvlerë denari".

Neni 3

Në nenin 18 fjalët: „prej 6.000 euro" zëvendësohen me fjalët: „prej 5.000 deri 10.000 euro", ndërkaq shlyhet nyja „i".

Neni 4

Neni 19 ndryshohet siç vijon:

„(1) Personit të autorizuar për pranimin e kallëzimeve të denoncuesve ose personit tjetër zyrtar do t'i shqiptohet gjobë në shumë prej 500 euro, në kundërvlerë denari, nëse vepron në kundërshtim me nenin 7 paragrafi (2) ose (3) të këtij ligji.

(2) Personit fizik që nuk është person zyrtar do t'i shqiptohet gjobë në shumë prej 250 euro, në kundërvlerë denari, nëse vepron në kundërshtim me nenin 7 paragrafi (3) të këtij ligji.

(3) edhe mikrotregtarit me 10 persona të punësuar do t'i shqiptohet gjobë në shumë prej 1.000 euro, në kundërvlerë denari; përkatësisht tregtarit të vogël ose institucionit me 10 persona të punësuar do t'i shqiptohet gjobë në shumë prej 2.000 euro në kundërvlerë denari; përkatësisht tregtarit të mesëm ose institucionit me 10 deri 50 persona të punësuar do t'i shqiptohet gjobë prej 6.000 euro në kundërvlerë denari; përkatësisht tregtarit të madh ose institucionit me më shumë se 50 persona të punësuar do t'i shqiptohet gjobë në shumë prej 10.000 euro në kundërvlerë denari, për kundërvajtje sipas paragrafit (1) të këtij neni.“.

Neni 5

Në nenin 20 ndryshohet paragrafi (1) siç vijon:

„(1) Mikrotregtarit me 10 persona të punësuar do t'i shqiptohet gjobë në shumë prej 500 deri 1.000 euro, në kundërvlerë denari; përkatësisht tregtarit të vogël ose institucionit me 10 persona të punësuar do t'i shqiptohet gjobë në shumë prej 1.000 deri 2.000 euro, në kundërvlerë denari; përkatësisht tregtarit të mesëm ose institucionit me 10 deri 50 persona të punësuar do t'i shqiptohet gjobë prej 3.000 deri 6.000 euro, në kundërvlerë denari; përkatësisht tregtarit të madh ose institucionit me më shumë se 50 persona të punësuar do t'i shqiptohet gjobë në shumë prej 5.000 deri në 10.000 euro, në kundërvlerë denari, nëse vepron në kundërshtim me nenin 9 paragrafi (2) të këtij ligji.“.

Në paragrafin (2) fjalët: „30% nga gjoba e përcaktuar për institucionin, përkatësisht personin juridik" zëvendësohen me fjalët: „500 euro në kundërvlerë denari".

Neni 6

Në nenin 21 paragrafi (1), pas fjalëve: „shumë prej" shtohen fjalët: „1.000 deri", ndërkaq shlyhet nyja „i".

Në paragrafin (2) fjalët: „30% nga gjoba e përcaktuar për institucionin, përkatësisht personin juridik" zëvendësohen me fjalët: „500 euro në kundërvlerë denari".

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë pas botimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".